


GJL. nr.871/2012



GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve: Ragip Namani kryetar, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtar, me pjesëmarrjen e sek. juridike Ganimete Dumani, duke vendosur sipas ankesës e të pandehurës Shpresa Hyseni, nga Prishtina, të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.42402/2011, të dt. 25.06.2012, e në bazë të neneve 31 al. 3, 39 dhe 221 të Ligjit për kundërvajtje, me datë 03.08.2012, bjen:

## A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është e bazuar.

NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.42402/2011, i datës. 25.06.2012, ashtu që ndaj të pandehurës Shpresa Hyseni, PEZULLOHET procedura kundërvajtëse, konform nenit 198 al. 1 pika 1 të Ligjit për Kundërvajtjet, pasi që vepra e cila i ngarkohet nuk është e përcaktuar si kundërvajtje. Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

## A r s y e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Regj.I.nr.42402/2011 të dt. 25.06.2012 të pandehurën Shpresa Hyseni, nga Prishtina, e ka shpallur përgjegjëse sepse si Gjyqtare në Gjykatën Komunale në Prishtinë, në deklarin e rregullt të pasurisë për vitin 2010 nuk e ka deklaruar tërë pasurinë që e posedon ajo dhe bashkëshorti i saj, pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor, edhe pse ka qenë e njoftuar se është përfshirë në listën e Zyrtarëve të cilët janë të obliguar ta bëjnë deklarin e plotë të pasurisë. Gjatë kontrollit nga Agjencioni Antikorrupsion i janë gjetur dy paluejtëshmëri në emër të bashkëshortit të saj në sipërfaqe prej 4321 m<sup>2</sup> dhe 10852m<sup>2</sup> të cilat pasuri janë të evidentuara në Zyrën kadastrale në Pejë me ç, veprim e pandehura ka bërë kundërvajtje nga neni 4 pika 1.1 dhe 3 lidhur me nenin 16 par.1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë publik me nr. 03/L-126, e për të cilën kundërvajtje i është shqiptuar gjoba në shumë prej 1.000€, Me të njëjtin aktvendim e pandehura është obliguar që në emër të paushallit gjygjësor të paguaj shumën prej 5€.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur e pandehura Shpresa Hyseni, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së Ligjit për Kundërvajtje dhe vendimit mbi dënim dhe më tutje në arsyetim ndër të tjera thekson: se asgjë nuk ka fshehur me qëllim nuk i është shmangur lajmërimit të kësaj pasurie, se me rastin e plotësimit të formularit i ka lajmëruar dy banesa në Prishtinë, veturën "JEEP", të cilat kanë vlerë disa herë më të madhe se sa patundshmëria në fshat e cila ka vlerë të vogël dhe bashkëshorti i saj është bashkëpronarë me 1/6 pjesë ideale, se mos lajmërimin e kësaj pasurie nuk e ka bërë me qëllim por nga mos kujdesi nga se e njëjta gjendet në Komunën e Pejës, se për vitin 2011 dhe 2012, ka deklaruar gjithçka edhe pse për atë pronë ende nuk është shqyrtuar trashëgimia, se AKK në momentet kur ka hasur në paregullësi për deklarin e pasurisë ka qenë e obliguar që ta thërras dhe të kërkoj sqarime në atë prej 15 ditë pas dorëzimit të formularit e jo të grisë fletëparaqitje në gjykatë ndaj saj, se nga gjykata e shkallës së parë është dënuar me gjobë shumë të lartë, se numri i Ligjit nr. 03/L-126, me të cilin është dënuar është Ligji për të Huaj, se kërkesa e AKK-së bazohet në Ligjin 04/L-050 i cili Ligj ka hyrë në fuqi më datë 30.09.2011, se

/...

05-5144/12/12  
Sugj

.....

dispozitat ligjore nuk e parashohin si vepër kundërvajtëse deklarimin jo të plotë të pasurisë, andaj nga të lartcekurat propozon që aktvendimi i goditur të abrogohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje ose i njejtë të ndryshohet dhe të lirohet nga vepra e cila i ngarkohet dhe gjoba e shqiptuar.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur kërkesën dhe plotësim kërkesën e Agjencisë Kundër Korrupsionit të datës 12.02.2012 si dhe shkresat tjera të lëndës dhe konstatoi se ankesa e paraqitur është e bazuar, kurse aktvendimin e goditur e ndryshoi ashtu që ndaj të pandehurës Shpresa Hyseni, PEZULLOHET procedura kundërvajtëse konform nenit 198 al.1 pika 1 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, sepse vepra e cila i ngarkohet dhe për të cilën është shpallur përgjegjëse me aktvendimin e shkallës së parë nuk është e përcaktuar si kundërvajtje.

Kolegji mori këtë vendim duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve publik Ligji nr. 03/L-151 i cili ishte në fuqi në kohën për periudhën raportuese të deklarimit të rregullt të pasurisë së zyrtarëve të lartë gjerë më 31. Mars 2011, e për të cilën ngarkohet e pandehura. E pandehura ka bërë deklarimin e rregullt të pasurisë për atë periudhë por jo të plot duke mos e deklaruar dy paluajtëshmëri e emër të bashkëshortit të saj dhe e njëjta me kërkesë të AKK-së ngarkohet se ka kryer kundërvajtje nga neni 16 pika 1.1 e i cili nen sanksionon mos deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë.

Kolegji vlerëson se mos deklarimi i tërësisht i pasurisë apo në mënyrë jo të plotë të pasurisë me Ligjin e cekur më lartë nuk sanksionohet si kundërvajtje, por në bazë të nenit 14 pika 3 të këtij Ligji Agjencia gjatë përpunimit të formularëve nëse vërteton se formulari i deklaruesit ka gabime materiale ose plotësime të gabuara e njofton subjektin i cili ka paraqitur këto deklarime që brenda afatit të caktuar se është i detyruar ti përmirësoi ato.

Ligji i ri nr. 04/L-050, i cili është në fuqi prej datë 30.09.2011 për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, po ashtu nuk e sanksionon si vepër kundërvajtëse deklarimin jo të plotë të pasurisë e as në dispozitat ndëshkimore të parapara në nenin 17 të këtij Ligji. Sipas këtij neni parashihen gjoba për mos deklarim të rregullt vjetor të pasurisë, mos deklarim të pasurisë me rastin e marrjes së detyrës, për mos deklarim e pasurisë sipas kërkesës së Agjencisë, mos deklarim pas largimit nga funksioni apo nëse nuk vepron në pajtim me paragrafin 3 të nenit 15 të këtij Ligji, por nuk sanksionon deklarimin jo të plotë të pasurisë.

Neni 15.3 i Ligjit 04/L-050 është edhe më i plotë se neni 14 i Ligjit të mëparshëm i cili saktëson se në Agjencion gjatë përpunimit paraprak nëse vërtetohen gabime materiale ose plotësime të gabuara **apo jo të plota** në këto raste Agjencia njofton subjektin që ka paraqitur këto deklarime i cili në afat të caktuar është i detyruar ti përmirësoi ato.

Nga të lartcekurat e konform nenit 221 të Ligjit mbi kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJL. nr.871 /2012, datë 03.08.2012.

SEK. JURIDIKE,

Ganimete Dumani

KRYETARI I KOLEGJIT

Ragip Namani